



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. MM12 Prot.

Tiranë, më 23.10.2018

UDHËZIM

NR. 33, datë 23.10.2018

PËR

**NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 21.05.2018 "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË VITIN AKADEMIK 2018-2019", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 4 të nenit 9 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në Udhëzimin nr. 18, datë 21.05.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ndryshuar, pas pikës 7 të Kreut IV "*Raundi i tretë*", shtohen pikat si më poshtë:

- “8. Kandidatët që nuk kanë arritur të aplikojnë në tre raundet (përfshirë këtu edhe ata që nuk kanë plotësuar formularin A1/A1Z), si dhe respektojnë kriterin e notës mesatare sipas vendimit nr. 216, datë 20.04.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019”, vijojnë me procedurat e regjistrimit pranë IAL-ve, jashtë portalit U-Albania.
9. Kandidatët aplikojnë pranë IAL-ve, në periudhën 29 tetor deri më 02 nëntor 2018.
10. IAL-të vijojnë me regjistrimin e kandidatëve deri në plotësimin e kuotave për programin përkatës të studimit.
11. Regjistrimi i kandidatëve (që paraqiten personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij) kryhet pranë sekretarive mësimore në datat 05 nëntor deri më 07 nëntor 2018, sipas dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim.
12. Aplikantët dorëzojnë (personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre), dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja.
  - b) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar.
  - c) Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.
13. Sekretaritë mësimore të fakulteteve të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të

regjistruar. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i regjistrimit, një prej të cilave i jepet aplikantit.

14. Institucionet e Arsimit të Lartë për arsye të numrit të ulët të studentëve të regjistruar në programe studimi të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, për vitin akademik 2018-2019, me vendim të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit ndërpresin regjistrimin e mëtejshëm të studentëve në këto programe studimi. Studentët që janë regjistruar në ciklin e parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, për vitin akademik 2018-2019, në programet e studimit që është ndërprerë regjistrimi me vendim të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit, kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtit institucion të arsimit të lartë, në programe studimi të ngjashme.
  15. Brenda datës 16 nëntor 2018, IAL-të përcjellin në QSHA regjistrimet përfundimtare në format elektronik dhe *hardcopy*.”.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, njësitë arsimore vendore dhe institucionet e arsimit të lartë.

*Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.*

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

